

2026-2028

PLANI I INTEGRITETIT

QENDRA E PRITJES PËR AZIL

PËRMBAJTJA

MIRËNJOHJE	3
I. HYRJE	4
II. QËLLIMI I DOKUMENTIT	5
III. OBJEKTIVAT DHE PARIMET	5
IV. METODOLOGJIA	6
V. IDENTIFIKIMI I FUSHAVE ME RISK NË QENDRËN E PRITJES PËR AZIL	7
➤ Risqe në fushën e Prokurimeve Publike	7
➤ Risqe në Fushën e Menaxhimit Financiar, të aseteve dhe shërbimeve mbështetëse	8
➤ Risqe në fushën e Burimeve Njerezore	8
VI. MONITORIMI DHE RAPORTIMI	9
VII. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	9
Plani i Veprimit për përmirësimin e Integritetit në Qendrën e Pritjes për Azil 2026-2028	10

FJALA HYRËSE

Korrupsioni në ditët e sotme është një ndër problematikat më të spikatura që përballen institucionet shtetërore por jo vetëm. Çështjet e integritetit dhe lufta ndaj korrupsionit kanë një rëndësi të veçantë kundrejt përmbushjes së standardeve të anëtarësimit në Bashkimin European. Forcimi i kapacitetit institucional në zbatim të ligjit për të sfiduar dhe reduktuar elementët e korrupsionit është një nga mënyrat më thelbësore për ta luftuar atë në mënyrë efektive dhe për të ndërtuar qasje të duhura ndaj tij.

Ky plan integriteti është një dokument i cili përbën një hap kryesor në orientimin e punonjësve të Qendrës drejt ndërgjegjësimit për luftimin e elementëve korruptive dhe konsiderimin e integritetit, etikës dhe transparencës si vlera primare ndaj funksionimit të përgjithshëm institucional. Ky plan shërben për identifikimin dhe parandalimin e risqeve ndaj korrupsionit në fushat që janë më të prirura ndaj këtyre elementëve dhe zbatimi i duhur i tij do të orientojë përmbushjen e standardeve që synohen për t'u arritur.

ERMIR ALIÇKA
DREJTOR I QENDRËS SË PRITJES PËR AZIL

MIRËNJOHJE

Ky plan u hartua nga punonjësit e Qendrës së Pritjes për Azil me mbështetjen e ekspertëve të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjisë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

I. HYRJE

Integriteti është një ndër parimet thelbësore për një sistem mirëqeverisës në institucionet shtetërore. Shteti në tërësi e humb legjitimitetin nëse institucionet e tij dhe përfaqësuesit nuk janë në gjendje t'i kryejnë funksionet e tyre në mënyrë të drejtë dhe të përgjegjshme. Përveç kësaj, mungesa e integritetit në administratën publike shpesh çon në humbje në buxhetin e saj. Kjo pengon zhvillimin e vendit dhe në të njëjtën kohë rrezikon urat e bashkëpunimit me ndërkombëtarët. Rritja e nivelit të integritetit është një domosdoshmëri për ndërtimin e një sistemi administrativ efikas dhe efektiv.

Njohja dhe vlerësimi i detajuar i risqeve të korrupsionit është kryesor për të ndërtuar qasje të duhura dhe për të ngritur mekanizma efektivë për reduktimin e minimizimin të ndikimit të tij. Në këtë kuadër Qendra e Pritjes për Azil ka hartuar Planin e Integritetit të saj si një dokument strategjik dhe mekanizëm për menaxhimin e risqeve të mundshme. Qendra e Pritjes për Azil synon të garantojë një standard të duhur të ofrimit të shërbimeve të saj kundrejt kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare që akomodohen në ambientet e Qendrës. Qendra funksionon në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme që nga viti 2004, me VKM Nr. 262, datë 23.04.2004 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit, në Babrru, Tiranë, Ministrisë së Rendit Publik” dhe Vendimi Nr.630 Datë 27.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qendrës së Pritjes për Azil”.

Organigrama e institucionit përbëhet nga titullari i institucionit që është organi ekzekutiv dhe administrata ku gjithsej ka 18 punonjës (përfshirë edhe organin ekzekutiv) sipas strukturës dhe organikës të miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr.143 datë 29.08.2025 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Pritjes për Azil”.

Qendra e Pritjes për Azil është subjekt monitorimi, mbikqyerje dhe vlerësimi nga një sërë mekanizmash ligjorë si Auditi i Brendshëm, Avokati i Popullit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ku linden detyrimet përkatëse mbi publikimin e informacioneve sipas veprimtarisë funksionale të Qendrës kundrejt transparencës së plotë në përputhje e në zbatueshmëri të ligjeve në fuqi.

II. QËLLIMI I DOKUMENTIT

Qëllimi i këtij plani është të kontribuojë në ngritjen e fuqizimin e kapaciteteve që ka Qendra e Pritjes për Azil për të identifikuar risqet që çënojnë integritetin e Qendrës si dhe të vlerësojë nivelin e ndikimit të tyre dhe të planifikojë masa të duhura përkatëse për ndërhyrje kundrejt reduktimit të këtij ndikimi për të garantuar shërbime cilësore dhe me standarde të duhura.

Ky dokument do të kontribuojë në parandalimin e elementëve të korrupsionit, pasi synon të promovojë dhe forcojë integritetin kundrejt profesionalizmit, etikës dhe standardeve të duhura profesionale.

III. OBJEKTIVAT DHE PARIMET

Plani i Integritetit është konceptuar për një shtrirje kohore tre vjeçare dhe synon të arrijë realizimin e disa objektivave kyçe:

- Parandalimin e elementëve të korrupsionit dhe forcimin e integritetit institucional dhe rritjen e transparencës së Qendrës së Pritjes për Azil.
- Krijimin e mekanizmave monitorues mbi çështje që çënojnë integritetin.
- Forcimin e bashkëpunimit midis strukturave të brendshme në kuadër të përmbushjes së detyrimeve në fushën e antikorrupsionit.

Dokumenti udhëhiqet nga disa parime thelbësore që ndërtojnë filozofinë e veprimtarisë së punës së institucionit dhe që ndikojnë drejtpërdrejt në forcimin e imazhit të tij ndaj integritetit:

- Parimi i ligjshmërisë,
- Parimi i llogaridhënies,
- Parimi i efektivitetit,
- Parimi i konfidencialitetit,
- Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit,
- Parimi i transparencës,
- Parimi i bashkëpunimit të brendshëm.

IV. METODOLOGJIA

Plani i Integritetit dhe Plani i tij i Veprimit vijnë si rezultat i punës të vazhdueshme disamujore të grupit të punës të specialistëve të Qendrës. Dokumenti u hartua në përputhje me Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit, miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, Nr.334, datë 07.10.2020 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore”.

Procesi i hartimit të këtij plani kaloi nëpër disa faza. Së pari, u ngrit grupi i punës për Hartimin e Planit të Integritetit të Qendrës së Pritjes për Azil, i përbërë nga specialistë të tre sektorëve të Qendrës, gjithashtu gjatë gjithë procesit është kërkuar asistim nga ekspertët e Drejtorisë së Politikave të Rendit dhe Sigurisë Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme në hartimin e Planit të Integritetit.

Së dyti, u vijua për zbatimin e afateve, masave dhe aktivitetet e planifikuara në kuadër të përgatitjes dhe finalizimit në kohë të Planit të Integritetit dhe të Planit të Veprimit të tij.

Së treti, janë zhvilluar takime të ndryshme me anëtarët e grupit të punës ku është diskutuar mbi vijimësinë e procesit. Grupi i punës u angazhua në përgatitjen e një analize të detajuar të situatës bazuar dhe në specifikat e sektorëve të përfshirë duke evidentuar çdo aspekt e proces pune. Ky proces përfshin disa elementë:

- Analizën e kuadrit ligjor sipas sektorëve lidhur me mangësitë, qartësitë dhe qëndrueshmëritë e tyre,
- Analizën e organizimit të brendshëm, strukturën organizative me ndryshimet e saj dhe problematikat e evidentuara,
- Analizën e procesit të hirearkisë vendimarrëse, rekrutimi dhe prokurimet.

Më pas është vijuar me përpunimin e informacioneve dhe organizimi i tyre në një dokument. Identifikimi i risqeve u bë në të gjitha proceset dhe fushat që u vlerësuan si fusha me ndikim të konsiderueshëm ndaj cënimit të mundshëm të integritetit të punonjësve dhe të institucionit në tërësi. Risqet e identifikuar u kategorizuan në disa grupe në ato të prokurimeve, të burimeve njerëzore dhe në fushën e menaxhimit financiar, projekteve, aseteve dhe shërbimeve mbështetëse.

Pas analizimit të procesit dhe fushave të evidentuara si të riskuara u bë integrimi i tyre në një dokument ku mbi bazën e tij u vijua nga grupi i punës me hartimin e Planit të Integritetit të

Qendrës së Pritjes për Azil dhe Planit të Veprimit 2026-2028 në zbatim të tij. Në këtë kontekst u vijuan takimet me ekspertët e Drejtorisë së Politikave të Rendit dhe Sigurisë Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme për identifikimin e masave dhe aktiviteteve të nevojshme e reale, që kanë impakt për caktimin e strukturave përgjegjëse, afateve kohore, objektivave dhe indikatorëve përkatës. Këto masa kanë të bëjnë me caktimin e përgjegjësive të funksioneve, hartimin e akteve rregullatore, trajnimin e punonjësve dhe përmirësimin e kontrollit të brendshëm. Para miratimit të drafteve përfundimtare të Planit të Integritetit dhe Planit të Veprimit u bë konsultimi me ekspertët në Ministrinë së Punëve të Brendshme për të vijuar me miratimin e tyre dhe zbatueshmërinë e planeve përkatëse.

V. IDENTIFIKIMI I FUSHAVE ME RISK NË QENDRËN E PRITJES PËR AZIL

➤ RISQE NË FUSHËN E PROKURIMEVE PUBLIKE

Prokurimi publik si një ndër elementët më të ekspozuar ndaj riskut të korrupsionit nga analiza e zhvilluar kjo fushë është identifikuar si një fushë me një risk të lartë. Procesi i prokurimit që realizohet nga punonjësit që janë pjesë e komisioneve të njësisë së prokurimit dhe komisioneve të vlerësimit të ofertave, për mallra dhe shërbime është i prekur nga elementët e korrupsionit me risqe që lidhen me manipulimin e proceseve të tenderimit, nisur që nga planifikimi për mallra dhe shërbime, përgatitja e dokumentacionit dhe specifikimeve teknike, në pranimin dhe vlerësimin e ofertave, shpalljen e fituesit deri në lidhjen e kontratave. Këto punonjës duhet të fokusohen në rezultatin që duhet të arrijë ky proces. Prokurimet duhet të mbështeten në nevoja reale dhe prioritetet konkrete.

Referuar këtyre elementëve që përbëjnë risk ndaj korrupsionit janë parashikuar masa si:

- Trajnimi i punonjësve për njohjen e procedurave të prokurimit publik për mallra dhe shërbime sipas ndryshimeve ligjore.
- Përmirësimi i hartimit të specifikimeve teknike duke përfshirë ekspertizën e duhur në të duke realizuar blerje në përputhje të plotë me dokumentacionin e përgatitur.
- Respektimi i afateve ligjore për çdo proces gjatë realizimit të procedurave të prokurimit.

➤ **RISQE NË FUSHËN E MENAXHIMIT FINANCIAR, TË ASETVE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Risqet në këtë fushë përfshijnë veprimtarinë e përditshme të institucionit në fushën e menaxhimit financiar dhe buxhetit, risqe në fushën e shërbimeve mbështetëse dhe menaxhimit të asetve. Menaxhimi i financave publike është një fushë e cila përfshin risqe të konsiderueshme potenciale që lidhen me elementët korruptive. Procesi i delegimit funksional dhe financiar në institucion është i bazuar në rregullime ligjore dhe hirearkike mbi ekzekutimin e fondeve, kryerjen e pagesave sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimet përkatëse.

Megjithatë procesi rrezikohet në drejtim të planifikimit dhe shpërndarjes buxhetore sipas prioriteteve dhe nevojave reale prioritare, mungesa e raportimit në kohë mbi ecurinë e zbatimit të buxhetit mund të çojnë në problem gjatë ekzekutimit të buxhetit dhe realizimit të objektivave. Referuar këtyre elementëve që përbëjnë risk ndaj korrupsionit në fushën e menaxhimit financiar janë parashikuar masa si:

- Rritja e kontrollit të brendshëm dhe drejtimi i duhur i proceseve të menaxhimit financiar për minimizimin e ndikimit të korrupsionit.
- Planifikim i saktë i nevojave reale për fonde ndërmjet planeve shumëvjeçare dhe buxhetit vjetor.
- Formulimi i saktë i planifikimit afatgjatë dhe afatshkurtër të buxhetit në përputhje me prioritetet dhe objektivat e Qeverisë.

➤ **RISQE NË FUSHËN E BURIMEVE NJËRËZORE**

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është një fushë e cila ka predispozita të larta ndaj risqeve korruptive që ndikojnë negativisht në ecurinë e punës së institucionit. Këto risqe mund të paraqiten në faza të ndryshme të tilla si emërimi, përzgjedhja, miratimi, hartimi i dokumentacionit, ndryshimi i rregulloreve, kodeve të ndryshme dhe mund të çënojnë mirëfunksionimin e institucionit.

Procesi i rekrutimit të punonjësve kryhet sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë në mungesë të një përcaktimi të procedurave dhe kriterëve në një rregullore të brendshme të miratuar, me qëllim të rritjes së transperencës institucionale vendet vakante publikohen në faqen zyrtare të Qendrës së Pritjes për Azil ku janë të përcaktuara kriteret përkatëse për vendin vakant, kërkesat specifike, aftësive, cilësive, përgjegjësitë e

pozicionit si dhe afatet kohore për ecurinë e përzgjedhjes së kandidatëve. Në kuadër të këtyre risqeve që ndikojnë në integritetin e institucionit janë planifikuar masat si:

- Publikimi i vendeve vakante në faqen zyrtare me të gjithë elementët përkatës për plotësimin e tij.
- Zbatimi korrekt i procedurave të parashikuara për rekrutimet dhe vlerësimi i dokumentacionit përkatës me rigorozitet të plotë.
- Rritja e rolit të strukturës dhe drejtuesit të saj në interes të plotësimit me efikasitet të vendeve vakante.

VI. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Zbatimi i Planit të Integritetit do t'i nënshtrohet një procesi periodik monitorimi. Ky proces do të realizohet me pjesëmarrës të grupit të punës nga strukturat përgjegjëse. Në kuadër të monitorimit grupi i punës do të hartojë raportime vjetore që do të shërbejnë për të vlerësuar shkallën e realizimit të masave, aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit. Bazuar në vlerësimin objektiv të arritjeve dhe risqeve, problematikave të hasura përgjatë implementimit të masave do të hartohen rekomandime për përmirësime të mëtejshme kundrejt përmirësimit të politikave institucionale në kuadër të parandalimit të korrupsionit dhe rritjes së integritetit.

VII. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Korrupsioni është një fenomen kompleks që merr forma të ndryshme në varësi të situatave, roleve, funksioneve, ndryshimeve të akteve rregullatore e ato ligjore apo teknologjike. Korrupsioni është një indikator i konsiderueshëm ndaj kërcënimit të sigurisë publike dhe lufta ndaj tij duhet të jetë e qëndrueshme dhe e vazhdueshme e që konsideron të gjithë elementët e tij.

Reduktimi i nivelit të ndikimit të tij arrihet nëpërmjet forcimit të sistemeve të llogaridhënies, rritjes së kontroleve të brendshme, rritjes së transparencës si dhe përmes promovimit të integritetit. Në këtë dokument përcaktohen sektorët/strukturat përgjegjëse, afatet kohore, treguesit për mënyrën e matjes së realizimit të masës dhe objektivat e synuara për secilën. Pas miratimit të dokumentit të gjithë strukturat përgjegjëse do të njihen me të dhe do të organizohen për të marrë masat përkatëse për zbatimin e detyrimeve për forcimin e qasjes parandaluese ndaj korrupsionit.

PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E INTEGRITETIT NË QENDRËN E PRITJES PËR AZIL 2026-2028

OBJEKTIVI I: RITJIA E INTEGRITETIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK

1	2	3	4	5	6	7	8	9
Nr.	Fusha me risk	Masa/Aktiviteti	Struktura përgjegjëse	Struktura të tjera përgjegjëse	Indikatorë matës	Objektivi për 2026	Objektivi për 2027	Objektivi për 2028
1.1	Mosrespektimi i procedurave të Prokurimit Publik me vlerë të vogël për mallra dhe shërbime, duke përfshirë vonesat dhe specifikime teknike jo të sakta.	<p>1.1.1 Njohja e çdo anëtari të komisionit me procedurat e prokurimit publik për mallra dhe shërbime sipas ndryshimeve të reja ligjore.</p> <p>1.1.2 Respektimi i afateve ligjore për çdo proces gjatë realizimit të procedurave.</p> <p>1.1.3 Përmirësim i hartimit të specifikimeve teknike duke përfshirë ekspertizën e duhur në to.</p>	<p>Komisioni i njësië së prokurimit</p> <p>Specialisti i Prokurimeve</p>	<p>Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse</p> <p>Komisioni i Pritjes së mallit/shërbimit</p>	<p>1.1.1 Numri i punonjësve të trajnuar.</p> <p>1.1.2 Raportime periodike për realizimin e prokurimeve brenda afateve ligjore dhe atyre të planifikuara.</p> <p>1.1.3 Respektimi dhe mosndikimi tek kërkesat dhe specifikimet teknike të përgatitura nga strukturat përgjegjëse.</p>	<p>1.1.1 Njohja e anëtarëve të komisionit të prokurimeve me procedurat e prokurimit publik për mallra dhe shërbime sipas ndryshimeve të reja ligjore.</p> <p>1.1.2 Realizimi i rekomandimeve të lëna nga Drejtoria e Auditit në Ministrinë e Punëve të Brendshme</p> <p>1.1.3 Blerje në masën 100%,</p>	<p>1.1.1 Njohja e anëtarëve të komisionit të prokurimeve me procedurat e prokurimit publik për mallra dhe shërbime sipas ndryshimeve të reja ligjore.</p> <p>1.1.2 Realizimi i rekomandimeve të lëna nga Drejtoria e Auditit në Ministrinë e Punëve të Brendshme</p>	<p>1.1.1 Njohja e anëtarëve të komisionit të prokurimeve me procedurat e prokurimit publik për mallra dhe shërbime sipas ndryshimeve të reja ligjore.</p> <p>1.1.2 Realizimi i rekomandimeve të lëna nga Drejtoria e Auditit në Ministrinë e Punëve të Brendshme</p> <p>1.1.3 Blerje në masën 100%,</p>

						në përputhje të plotë me kërkesat dhe specifikimet teknike.	1.1.3 Blerje në masën 100%, në përputhje të plotë me kërkesat dhe specifikimet teknike.	në përputhje të plotë me kërkesat dhe specifikimet teknike.
OBJEKTIVI II: RRRITJA E INTEGRITETIT NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE								
1	2	3	4	5	6	7	8	9
Nr.	Fusha me risk	Masa/Aktiviteti	Struktura përgjegjëse	Struktura të tjera përgjegjëse	Indikatorë matës	Objektivi për 2026	Objektivi për 2027	Objektivi për 2028
2.1	Mungesa e procedurave të miratuara apo moszbatimi i tyre në rekrutimin e punonjësve në QPA.	2.1.1 Publikimi në faqet zyrtare i vendeve vakante. 2.1.2 Zbatimi korrekt i procedurave të parashikuara për rekrutimet dhe vlerësimi i dokumentacionit	Specialisti i Burimeve Njerëzore	Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve të Brendshme Mbështetëse Komisioni AdHoc	2.1.1 Publikimi i vendeve vakante në faqet zyrtare të Qendrës së Pritjes për Azil. 2.1.2 Rekrutimi i punonjësve bazuar në Urdhërin e ngritur për Komisionin AdHoc nga Titullari i Institucionit.	2.1.1 Vende vakante 100% të publikuara. 2.1.2 Të gjitha rekrutimet e kryera sipas procedurës së miratuar.	2.1.1 Vende vakante 100% të publikuara. 2.1.2 Të gjitha rekrutimet e kryera sipas procedurës së miratuar.	2.1.1 Vende vakante 100% të publikuara. 2.1.2 Të gjitha rekrutimet e kryera sipas procedurës së miratuar.
2.2	Rekrutimi i punonjësve në shkelje të kriterëve të ligjeve të veçanta	2.2.1 Rritja e rolit të strukturës dhe drejtuesit të saj në interes të plotësisimit eficient të vakancave, duke	Specialisti i Burimeve Njerëzore	Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve të	2.2.1 Ndryshimi i akteve aktuale të identifikuara.	2.2.1 Hartimi dhe zbatimi i procedurave përkatëse.	2.2.1 Zbatimi i procedurave të miratuara.	2.2.1 Zbatimi i procedurave të miratuara.

	dhe procedurave të pranimit të tyre mbi baza preferenciale	qënë autoriteti kryesor për përcaktimin e kritereve dhe kërkesave për pozicionin që do të plotësohet dhe respektimi i këtyre kritereve dhe kërkesave.		Brendshme Mbështetëse	2.2.2 Numri i ankesave.	2.2.2 Reduktim me 20% të ankesave.	2.2.2 Reduktim me 20% të ankesave.	2.2.2 Reduktim me 20% të ankesave.
		2.2.2 Saktësimi i kritereve rekrutim për punonjësit.		Komisioni Ad Hoc				
		2.2.3 Rritja dhe garantimi i integritetit të komisioneve të pranimit si dhe garantimi i qëndrueshmërisë së tyre ndaj ndërhyrjeve dhe presioneve të ndryshme						

OBJEKTIVI III: RITJJA E INTEGRITETIT NË FUSHËN E MENAXHIMIT FINANCIAR, TË ASETEVE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

1	2	3	4	5	6	7	8	9
Nr.	Fusha me risk	Masa/Aktiviteti	Struktura përgjegjëse	Struktura të tjera përgjegjëse	Indikatorë matës	Objektivi për 2026	Objektivi për 2027	Objektivi për 2028
3.2	Planifikimi i shpenzimeve buxhetore të institucionit, jo sipas kërkesave të sektorëve, apo	3.2.1 Planifikim i saktë i nevojave reale për fonde ndërmjet planeve shumëvjeçare dhe buxhetit vjetor.	Nëpunësi Autorizues Nëpunësi Zbatues	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e	3.3.1 Reduktimi i numrit të rialokimeve të buxhetit gjatë vitit mbi	3.3.1 Ulje në masën 10% e numrit të rialokimeve nga planifikimi	3.3.1 Ulje në masën 10% e numrit të rialokimeve nga planifikimi	3.3.1 Ulje në masën 10% e numrit të rialokimeve nga planifikimi

	<p>nevojave prioritare dhe të pabazuar në një proces gjithëpërfshirës dhe transparent diskutimi.</p>	<p>3.2.2 Formulimi i saktë i planifikimit afatgjatë dhe afatshkurtër të buxhetit në përputhje me prioritetet dhe objektivat e qeverisë.</p>		<p>Punëve të Brendshme</p>	<p>rishpërndarjen e fondeve. 3.3.2 Rritje e trajnimeve të stafit me qëllim rritjen e efikasitetit të përdorimit të fondeve, hartimin e analizave, raporteve mbi risqet e lidhura, pakësimet e mundshme dhe pasojat.</p>	<p>fillestar i buxhetit vjetor. 3.2.2 Rritje me 30% e trajnimeve të stafit.</p>	<p>fillestar i buxhetit vjetor. 3.2.2 Rritje me 30% e trajnimeve të stafit.</p>	<p>fillestar i buxhetit vjetor. 3.2.2 Rritje me 30% e trajnimeve të stafit.</p>
--	---	---	--	----------------------------	---	---	---	---